

## PROPOZIME TË LIDHJES SË SHOQATAVE TË PENSIONISTËVE TË MAQEDONISË

Të gjitha këto masa që do të pasojnë ndërlidhen me pritjet e institucioneve ndërkombëtare financiare që presionet çmimore në tregjet ndërkombëtare gjatë këtij viti gradualisht do të zbuten, në mënyrë që të stabilizohen tashmë vitin e ardhëshëm

Shkup, 17 gusht - Lidhja e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë propozon paket masa antikrizë për të cilat mendon që do të ndihmojnë që të tejkalohet gjendja e krizës ekonomike, energjetike dhe pandemisë dhe dotë kontribuojnë në përmirësimin e standardit jetësor të pensionistëve.

Propozimi i masave antikrizë do të ishte në më shumë nivele: nga shteti, nga komunat, nga vetë shoqatat e pensionistëve si dhe nga institucione të ndrushme humanitare dhe organizata joqeveritare sikur është Kryqi i kuq dhe të tjera. Në kuadër të 76-të milion euro të siguruara me rebalancing e Buxhetit të RMV për paketat masa antikrizë për përbalimin e me pasojat e krizës botërore dhe energjetike, 330.000 pensionistë përpos rritjes së pensionit presin dhe kërkojnë në krijimin e masave të kyçet edhe Lidhja e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, si përfaqësues i tyre legjitim i cili më së miri e njih gjendjet pothuajse të çdo individit nëpërmjet 53 shoqatave të veta, anëtare e kësaj popullësie më massive në vend. Në këtë pjesë do të propozojmë përpos rritjes së pensioneve edhe:

**Niveli parë** do të ishin masa të cilat do të mund ti përkrahte Qeveria e RMV:

- Përkrahje financiare për energji elektrike për persona me pensione të ulëta;
- Ndihmë financiare për furnizim me dru për ngrohje dhe peletë për pensionistë dhe të personave në moshë me të ardhura të ulëta;
- Mjete financiare në lloje të formave të ndryshme;
- Subvencione për pagesën e një pjese të barnave të cilat janë të shtrenjta, ndërsa nuk janë në listën pozitive;
- Ngrija e çmimeve të produkteve themelore për ushqim;
- Suspendimi, gjegjësisht ndalimi i ligjit për përmbarrim;
- Dhe ndihma tjera në dukje të vogla për shtetin, ndërsa të mëdha për personat në moshë.

Në shtojcë të këtyre kërkesave dhe deklaratës së ministrit për financa Fatmir Besimi

# KËSHTU NDIHMOJNË NË STANDARDIN JETËSORË TË PENSIONISTËVE!



i cili thotë:

"Masat antikrizë do të jenë të targetuara. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut me masa të shumta në kohë, përgjegjëse dhe gjithëpërfshira dhe zgjidhje do të sigurojë mbrojtje për qytetarët nga rritjet të shkaktuara nga kriza globale, ekonomike dhe kriza energjetike. Ajo do të thotë se këto mjete do të drejtohen kah kategoritë e prekura të qytetarëve dhe ekonomisë, kah ata të cilët kanë më së shumti nevojë. Të gjitha këto masa që do të pasojnë ndërlidhen me pritjet e institucioneve ndërkombëtare financiare që presionet çmimore në tregjet ndërkombëtare gjatë këtij viti gradualisht do të zbuten, në mënyrë që të stabilizohen tashmë vitin e ardhëshëm".

Ministri thekson se na pret dhe një periudhë e rëndësishme, në të cilën krijimi i opinioit public do të jetë po aq i rëndësishëm në mos më i rëndësishëm sesa masat konkrete ekonomike që do të merren. Në këtë kontekstjanë edhe propozimet e LSHPM me qëllim që të ndikojë në opinionin publik në krijimin e politikave që përmbajnë në masat antikrizë për shfrytëzuesit e pensioneve.

**Niveli dytë**, përveç shtetit, Lidhja llogaritet që në ndihmë të pensionistëve në kohë të krizës ekonomike dhe energjetike duhet të kyçen edhe vetë komunat nëpërmjet organizimit të ndihmave të ndryshme siç janë:

- o Transpord pa pagesë në qytet dhe në vendet e banuara;

· Hapjen e qendrave ditore dhe përforcimin e atyre ekzistuese;

· Shpërndarja e vauçerëve dhe paketave me produkte ushqimore, mjeteve për higjienë dhe të tjera;

· Zbritje në objektet e banjove dhe të tjera nën ingerencat e vetqeverisjes lokale;

· Ndihmë në kushte shtëpiake nëpërmjet bashkëpunimit të institucioneve të ndryshme etj.

**Niveli tretë** do të ishin shoqatat e pensionistëve të cilat deri më tani dhe tani e bëjnë me sukses. Në këtë nivel të treë është përforcimi i volunterizmit dhe pjesëmarrjes intensive të SHPM "2022 viti I pensionistit rural" me të cilin do të përfshihen pensionistët në fshatra.

Në drejtim të përmirësimit të standardit të pensionistëve inkurajon edhe deklarata e ministrit për punë dhe politikë sociale Jovana Trençevska e cila premton: "Së bashku me Lidhjen e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë do të vazhdojmë të krijojmë masa dhe politika të cilat do të dedikohen për pensionistët, të cilatdo të nënkuptojnë ndihmë dhe përkrahje dhe në periudhën e ardhëshme me qëllim të përmirësimit e standardit të pensionistëve dhe personave në moshë". Të shpresojmë në sjellje të përgjegjshme të të gjitha subjekteve, që ta tejkalojmë edhe këtë krizë, siç e kaluam krizën më të madhe ekonomike të shkaktuar nga kovid 19 pandemia.




pleks dhe rrethin më gjërë. Falenderim të veçantë deri të kompanja Buçim e cila kontribuoi në organizimin që takimi i pensionistëve të jetë sa më i mirë.

## Mbledhja e pensionistëve në kompleksin "Manastiri Oraovik"

Me 23.07.2022, në organizim të SHP Radovish dhe Konçe, u mbajt mbledhja tradicionale e pensionistëve në kompleksin "Manastiri Oraovik", Radovish. Pas pauzës dyvjecare të kovid pandemisë, pvarësisht fazës së portokalltë klimatike me kohë të nxehtë, takim ishte masiv. Ishin prezentë mbi 300 pensionistë nga të gjitha anët e Maqedonisë, me të cilën u vërtetua se pensionistët kanë dëshirë të shoqërohen dhe zbavitën. Muzika e gjallë bëri që shoqërimi të jetë i ndritshëm, me disponim dhe gëzim e

shoqëruar me valle dhe këngë. Në fillim, kryetari i SHP Radovish Mite Stefanov u dëshiroi mirëseardhje dhe disponim të këdshëm pensionistëve të pranishëm. Përsëritje deri te pensionistët e pranishëm iu drejtuan edhe: Kryetari i Komunës së Radovishit Aco Ristov, përfaqësuesi i SHP Komuna Konçe, zëvendës kryetari i Këshillit ekzekutues të LSHPM Mentor Çoku dhe Nikollajço Nikollov, themelues i kishës së manastirit Shën Georgij e cila është në vitin 2012 e cila e rrethon me shpirtë këtë kom-



## Promovohet "Jeta në gërsheta" e Mitat Sinanit

Më 09.08.2022, në organizim të Shoqatës së pensionistëve Saraj, u promovua libri me titull "Jeta në gërsheta" të autorit Mitat Sinani. Promovimi u mbajt në Klubin e shoqatës ku morën pjesë pensionistë, anëtarë të SHP Saraj. Në takimin moderatori Mahir Duraku, e prezantoi autorin, duke e përkujtuar që janë nga vendanimit i njëjtë dhe se jetën si fëmijë dhe të rinjë e kanë kaluar bashkë. Iu falenderua autorit për mundin e dhënë, duke theksuar se ky është libri i parë i tij. Baki Bakui, i cili është redaktor i librit, pasiqë dha të dhëna biografike për autorin foli më gjërësisht për librin e tij. Mes të tjerash ai theksoi që Mitat Sinani këtë libër ka shkruar në diasporë. Libri është një monografi në të cilën autori flet detalisht për jetën e tij, duke filluar që nga fëmijëria e deri në moshën e tretë të jetës. Ai në librin shkruan për vendlindjen e tij fshatin Kopanicë, për jetën kur ka qenë fëmijë, për shkollimin e tij, kushtet e vështira për shkollim, për momente të shërbimit ushtarak dhe të tjera.

Një pjesë të librit ia kushton punës në diasporë, për anët e saja të mira dhe të këqija me të cilat është ballafaquar në punë si mësimdhënës atje, me fëmijët e nacionalitetit shqipëtarë, si përkthyes dhe të tjera. Librin e zbulon me tre këngë të tija: "Gjuha jonë", "Nëna ime", "Plaga e gurbetit", derisa librin e fillon me një poezi nga Nënë Tereza me titull "Jeta", ndërsa e përfundon me një këngë nga autor i panjohur me titull "Askujt nuk i kam borxh në jetë". Libri është i ilustruar me rreth tridhjetë fotografi me të cilat autori tregon momente të jetës së tij, deku filluar nga fëmijëria e deri sot, si dhe shtatë fjalë të urta të cilat flasin për jetën, të vendosura në vende adekuate në librin. Në fund të promovimit foli dhe autori i librit Mitat Sinani i cili iu falenderua organizatorit të takimit, Shoqatës së pensionistëve Saraj, si dhe të pranishmëve duke shprehur mes tjerash se librin e ka përgatitur në diasporë dhe pasi që foli për librin, theksoi që ka shkruar një numër të madh të këngëve me tematikë, dasurie për atdheun, të cilat mund të jenë në një botim të radhës.